



VENDIM PËR HEQJEN E ANKESËS NGA LISTA

Data e miratimit: 25 gusht 2014

Numri i lëndës: 2014-01

Nexhat Qubreli

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 25 gusht 2014, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese
Z. Guénaël METTRAUX, anëtar
Znj. Katja DOMINIK, anëtare

Ndihmuar nga:
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtar ligjor
Z. Florian RAZESBERGER, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetorit 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit me 9 qershor 2010,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PRANË PANELIT

1. Ankesa është parashtruar nga djali i ankuesit, Besart Qubreli, i cili ka ofruar autorizimin, të nënshkruar nga babai i tij. Lënda është regjistruar më 8 janar 2014.

2. Më 2 korrik 2014, Sekretariati i Panelit i ka dërguar një letër përfaqësuesit të ankuesit, ku i ka kërkuar atij që të ofronte informatë shtesë rreth lëndës, në veçanti të sigurojë ndonjë dokument që mendohet të jetë i rëndësishëm për ankesën. Z. Qubreli nuk e ka bërë atë.
3. Më 1 gusht 2014, Paneli edhe një herë ka kërkuar nga djali i ankuesit që të siguronte dokumentet e kërkuara dhe ka njoftuar atë se nëse nuk i përgjigjet letrës, Paneli mund të konsideroj se ankuesi nuk ka ndërmend ta vazhdoj ankesën e tij dhe kështu mund ta heq atë nga lista e lëndëve.
4. Ankuesi dhe përfaqësuesi i tij nuk kanë arritur t'ju përgjigjen kërkesave të Panelit apo të kontaktojnë Panelin brenda afatit kohor të caktuar.

II. FAKTET

5. Faktet e lëndës, siç janë paraqitur nga djali i ankuesit, mund të përmbliidhen si më poshtë:
6. Ankuesi ishte nën presion nga prokurori i EULEX-it për të dhënë informata në lidhje me një varr masiv të zbuluar në Rashkë. Ankuesi kishte refuzuar të ofroj informatat e kërkuara, pasi kishte frikë për sigurinë e vet.
7. Si hakmarrje e supozuar për shkak të refuzimit të tij, prokurori i EULEX-it e ka akuzuar ankuesin për krime të luftës. Ndërsa ankuesi ishte futur në paraburgim.

III. ANKESAT

8. Ankuesi pretendon se veprimet e prokurorit janë në kundërshtim me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, veçanërisht të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

IV. LIGJI

9. Sipas rregullës 29 e *tutje*, paragrafi 1 i rregullores së vet të punës, Paneli mundet që në çdo fazë të procedurës të vendosë që ta heq ndonjë ankesë nga lista e lëndëve, atëherë kur rrethanat çojnë në përfundim se ankuesi nuk ka qëllim ta vazhdoj ankesën e tij/saj.
10. Pasi përfaqësuesi i ankuesit nuk iu është përgjigjur kërkesave të vazhdueshme të Panelit për informata, duket se ankuesi ka humbur interesimin për vazhdimin e ankesës së tij. Si rrjedhojë dhe në mungesë të një treguesi për ndonjë shkelje të rëndë të të drejtave të njeriut (shih rregullën 29 e *tutje*, paragrafin 2 të rregullores së punës),

Paneli ka konstatuar se nuk do të jetë e arsyetohet në këto rrethana të vazhdohet shqyrtimi i kësaj ankese.

PËR KËTO ARSYE, Paneli njëzëri,

vendos që të heq këtë ankese nga lista e lëndëve, në pajtim me rregullën 29 e *tutje* paragrafin 1 (a) të rregullores së punës.

Për Panelin,

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor

Magda MIERZEWSKA
Kryesuese